



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2022 – Numri: 156

Tiranë – E martë, 22 nëntor 2022

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 83/2022, datë 17.11.2022	Për mosmiratimin e raportit të pakicës parlamentare në Këshillin për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, me objekt konstatimin e pavlefshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetes Olta Xhaçka. 18829
Vendim i Kuvendit nr. 84/2022, datë 17.11.2022	Për miratimin e raportit të shumicës parlamentare në Këshillin për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, me objekt konstatimin e pavlefshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetes Olta Xhaçka. 18829
Dekret i Presidentit nr. 13871, datë 16.11.2022	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 18829
Udhëzim i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 29, datë 7.10.2022	Për frekuentimin e procesit mësimor, sipas llojit të veprimtarive mësimore në auditor, dhe ciklit të studimit..... 18830
Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 270, datë 11.11.2022	Për miratimin e formularit të vetëdeklarimit për gjendjen gjyqësore për marrjen e kualifikimit të drejtimit të mjetit lundrues për shërbimet e ofruara nga Drejtoria e Përgjithshme Detare..... 18830
Urdhër i drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave nr. 633, datë 18.11.2022	Për delegim kompetencash..... 18835
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 26, datë 27.10.2022	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 69, datë 10.8.2020, të Gjykatës Administrative të Apelit, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë..... 18835
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 27, datë 27.10.2022	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr. 102, datë 9.12.2020, të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 46, datë 26.11.2020, të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Konstatimin e shkeljes së neneve 6, pika 1 dhe 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut..... 18842

Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 17391, datë 17.11.2022	Mbi hyrjen në fuqi të marrëveshjes ndërkombëtare.....	18847
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 795/9, datë 17.11.2022	Për shpronësim dhe/ose shkëmbim, të pronës për interes publik në zonën e re për zhvillim në Njësinë Administrative nr. 11, “Universiteti Bujqësor i Tiranës”.....	18847
Akt marrëveshjeje nr. 25076, datë 11.11.2022	Ndërmjet Grupeve të Interesit Përfaqësues të Autoshkollave, Shoqatës Kombëtare të Autoshkollave, Shoqatës së Autoshkollave “Siguria në rrugë” dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.....	18851
	Korrigjim gabimi material në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 284, datë 7.11.2022, “Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE- s nr. 150, datë 10.6.2022, ‘Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë ‘Danske Commodities Albania’ sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 152, datë 15 nëntor 2022.....	18853

**VENDIM
Nr. 83/2022****PËR MOSMIRATIMIN E RAPORTIT TË
PAKICËS PARLAMENTARE NË
KËSHILLIN PËR RREGULLOREN,
MANDATET DHE IMUNITETIN,
ME OBJEKT KONSTATIMIN E
PAVLEFSHMËRISË DHE MBARIMIT
TË MANDATIT TË DEPUTETES
OLTA XHAÇKA**

Në mbështetje të nenit 70 të Kushtetutës, të neneve 13, pika 7, 55 dhe 119/1 të Rregullores së Kuvendit,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË****VENDOSI:**

I. Mosmiratimin e raportit të pakicës parlamentare në Këshillin për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, me objekt konstatimin e pavlefshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetes Olta Xhaçka.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE
Lindita Nikolla**

Miraturar në datën 17.11.2022

**VENDIM
Nr. 84/2022****PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË
SHUMICËS PARLAMENTARE NË
KËSHILLIN PËR RREGULLOREN,
MANDATET DHE IMUNITETIN, ME
OBJEKT KONSTATIMIN E
PAVLEFSHMËRISË DHE MBARIMIT
TË MANDATIT TË DEPUTETES
OLTA XHAÇKA**

Në mbështetje të nenit 70 të Kushtetutës, të neneve 13, pika 7, 55 dhe 119/1 të Rregullores së Kuvendit,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË****VENDOSI:**

I. Miratimin e raportit të shumicës parlamentare në Këshillin për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, me objekt konstatimin e pavlefshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetes Olta Xhaçka.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE
Lindita Nikolla**

Miraturar më datë 17.11.2022.

**DEKRET
Nr. 13871, datë 16.11.2022****PËR DHËNIE TË SHKETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, dhe nenit 93, të Kushtetutës, si dhe të nenit 6, nenit 20 dhe në vijim, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Florentina Bujar Bislimi
2. Xheladin Mehdi Pulaj
3. Hekuran Ismen Kadriaj
4. Ardit Faruk Beqa
5. Fatime Bejtulla Memaj
6. Valdeta Vedat Buza (Metlilo)
7. Fitim Sali Koci
8. Diamant Skender Guci

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**



UDHËZIM
Nr. 29, datë 7.10.2022

PËR FREKUENTIMIN E PROCESIT
MËSIMOR, SIPAS LLOJIT TË
VEPRIMTARIVE MËSIMORE NË
AUDITOR, DHE CIKLIT TË STUDIMIT

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 3, të nenit 87, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, dhe vendimit nr. 824, datë 24.12.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”, ministri i Arsimit dhe Sportit

UDHËZON:

1. Përcaktimi i frekuentimit të procesit mësimor, sipas llojit të veprimtarive mësimore në programet e studimit me karakter profesional, programet e ciklit të parë, të dytë dhe të tretë të studimit.

2. Llojet e veprimtarive mësimore në auditor janë, si më poshtë:

- a) leksion;
- b) seminar/ushtim;
- c) laborator;
- ç) praktikë profesionale/klinike/kërkimore-shkencore.

3. Frekuentimi i procesit mësimor përcaktohet në rregulloren e programit të studimit.

Frekuentimi i leksioneve është si rregull fakultativ, por institucionet e arsimit të lartë mund të përcaktojnë, në aktet e tyre të brendshme rregullatore, frekuentim për lëndë/grup lëndësh të veçanta.

Për llojet e tjera të veprimtarive në auditor frekuentimi është, si më poshtë:

a) Për programet e studimit me karakter profesional, programet e studimit të ciklit të parë, programet e studimit të ciklit të dytë, “Master profesional”, programet e studimit të ciklit të dytë, “Master i shkencave”/“Master i arteve” dhe programet e studimit të ciklit të tretë “Master ekzekutiv”, veprimtaritë e tjera mësimore në auditor janë, si më poshtë:

- i. seminare/ushtime: 75%;
- ii. laboratorë: 75%;
- iii. praktika profesionale/klinike: 75%.

b) Për programet e studimit të ciklit të tretë “Specializim afatgjatë të ciklit të tretë” dhe programet e studimit të ciklit të tretë “Doktoratë”, që përmbajnë si pjesë të tij, lëndë të formimit teorik, veprimtaritë mësimore të tjera në auditor janë, si më poshtë:

- i. seminare/ushtime: 50%;
- ii. laboratorë: 75%;
- iii. aktivitete profesionale/klinike/kërkimore-shkencore: 75%.

4. Institucionet e arsimit të lartë, në aktet e tyre rregullatore dhe për fusha specifike të programeve të studimit mund të rritin masën e frekuentimit të procesit mësimor, të përcaktuar në këtë udhëzim.

5. Në rastet kur një IAL lëshon diplomë të përbashkët ose të dyfishtë me një IAL të huaj, frekuentimi i procesit mësimor bëhet sipas parashikimeve të këtij udhëzimi ose të marrëveshjes midis palëve.

6. Udhëzimi nr. 13, datë 20.6.2022, “Për frekuentimin e procesit mësimor, sipas llojit të veprimtarive mësimore në auditor dhe ciklit të studimit”, shfuqizohet.

7. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi Ministria e Arsimit dhe Sportit, Agjencia për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Evis Kushi

URDHËR
Nr. 270, datë. 11.11.2022

PËR MIRATIMIN E FORMULARIT TË
VETËDEKLARIMIT PËR GJENDJEN
GJYQËSORE PËR MARRJEN E
KUALIFIKIMIT TË DREJTIMIT TË
MJETIT LUNDRUES PËR SHËRBIMET
E OFRUARA NGA DREJTORIA E
PËRGJITHSHME DETARE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të pikës 1, të nenit 13, të ligjit nr. 127/2020, “Për regjistrimin, mënyrën e përdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese turistike dhe të argëtimit”,



URDHËROJ:

1. Miratimin e formularit të vetëdeklarimit për gjendjen gjyqësore për marrjen e kualifikimit të drejtimit të mjetit lundrues, për shërbimet e ofruara nga Drejtoria e Përgjithshme Detare, sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij urdhri dhe pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Detare për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
DHE MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

Lidhja nr. 1

FORMULARI I VETËDEKLARIMIT PËR GJENDJEN GJYQËSORE PËR MARRJEN E
KUALIFIKIMIT TË DREJTIMIT TË MJETIT LUNDRUES, PËR SHËRBIMET E OFRUARA NGA
DREJTORIA E PËRGJITHSHME DETARE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

FORMULAR VETËDEKLARIMI

NË ZBATIM TË NENIT 13, PIKA 1 TË LIGJIT NR. 127/2020 " PËR REGJISTRIMIN, MËNYRËN E
PËRDORIMIT DHE KONTROLLIN E MJETEVE LUNDRUESE TURISTIKE DHE TË ARGËTIMIT "

DATE: __ / __ / ____

I. TË DHËNAT PERSONALE

A. Gjeneralitetet aktuale:

EMËR	
MBIEMËR	
ATËSI	
AMËSI	
DATËLINDJE	
VENDLINDJE	
VENDBANIM	
NR. ID	

B. Gjeneralitete të mëparshme:

(Nëse keni ndryshuar zyrtarisht ndonjë nga të dhënat e gjeneralitetit tuaj, apo keni përdorur një gjeneralitet tjetër, qoftë edhe pa e ndryshuar zyrtarisht, listoni secilin prej tyre, duke plotësuar të gjitha të dhënat që janë ndryshuar dhe atë herë sa janë ndryshuar. Mosdeklarimi i ndonjë gjeneraliteti sipas kësaj pike, që mund të pengojë verifikimin sipas dispozitave të ligjit nr. 138/2015, përbën vepër penale sipas nenit 190 të Kodit Penal.)

(emër, mbiemër, nënshkrim)

Faqe 1



EMËR	
MBIEMËR	
ATËSI	
AMËSI	
DATËLINDJE	
VENDLINDJE	

II. MARRJE DIJENI MBI EFEKTET E FORMULARIT TË VETËDEKLARIMIT

Unë, i/e nënshkruari /a _____ kam marrë dijeni dhe jam i vetëdijshëm se:

- Ky Formular përbën dokument zyrtar që i drejtohet një organi shtetëror dhe i nënshtrohet verifikimit dhe publikimit.
- Pasqyrimi i të dhënave të rreme në këtë Formular përbën vepër penale dhe dënohet me burgim sipas nenit 190 të Kodit Penal.
- Të dhënat e pasqyruara në këtë Formular i nënshtrohen verifikimit të plotë, brenda dhe jashtë Shqipërisë, nga organet shtetërore dhe Prokuroria e Përgjithshme.
- Me plotësimin e këtij Formulari, kam dhënë pëlqimin për verifikimin e çdo të dhëne personale, përfshirë gjurmët daktiloskopike dhe çdo të dhënë tjetër biometrike.
- Pasqyrimi i të dhënave të pavërteta, të paplota, dhe të pasakta në këtë Formular dhe refuzimi i depozitimit të gjurmëve daktiloskopike, passjell skualifikimin e menjëhershëm dhe në çdo kohë nga kandidimi/zgjedhja/emërimi apo ushtrimi i mëtejshëm i funksionit publik.
- Trajtimi i të dhënave do të kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke qenë i vetëdijshëm për pasojat ligjore në rast të deklarimeve të pavërteta, të paplota apo të pasakta, konfirmoj saktësinë e të dhënave të pasqyruara në këtë Formular.

KUJDES! JENI I/E SIGURT? SUGJEROHET QË NËNSHKRIMI I KËTIJ SEKSIONI TË BËHET PASI ËSHTË PLOTËSUAR SAKTË I GJITHË FORMULARIT!

(emër, mbiemër, nënshkrim)

Faqe 2



(emër, mbiemër, nënshkrim)

III. TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT

1. A jeni dënuar ndonjë herë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj për krime në fushën e terrorizmit?

(vendos X përbri përgjigjes)

PO

☐

JO

☐

Nëse po, specifikoni të dhënat e mëposhtme:

Të dhënat e vendimit gjyqësor				
Gjykata	Nr. dhe data e vendimit gjyqësor të formës së prerë	Masa e dënimit me burgim	Vepra penale për të cilën jeni dënuar	
			Neni	Lloji

2. A jeni dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj, për trafikim të qenieve njerëzore, të lëndëve narkotike, të armëve, të lëndëve kimike dhe radioactive ?

(vendos X përbri përgjigjes)

PO

☐

JO

☐

Nëse po, specifikoni të dhënat e mëposhtme:

(emër, mbiemër, nënshkrim)

Faqe 3



Të dhënat e vendimit gjyqësor				
Të dhënat e vendimit gjyqësor jopërfundimtar	Gjykata	Vepra penale për të cilën jeni dënuar		Vendimi përfundimtar/Dënimi
		Neni	Lloji	

3. A jeni dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj, për kalimit të paligjshëm të kufirit, ose të transportit të kundërligjshëm të mjeteve monetare?

(vendos X përmbri përgjigjes)

PO ☐

JO ☐

- Nëse po, specifikoni të dhënat e mëposhtme:

Organi procedues	Qyteti, Shteti	Arsyet	Periudha/Data	Rezultatet

(emër, mbiemër, nënshkrim)

**URDHËR****Nr. 633, datë 18.11.2022****PËR DELEGIM KOMPETENCASH**

Në mbështetje dhe zbatim të nenit 11/“b”, të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat”, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të nenit 11, pikave 2 dhe 3, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, z. Endrit Musaj, drejtor i Inspektimit dhe Trajnimeve, për shkak të mungesës me arsye të titullarit të këtij institucioni.

2. Kompetencat e drejtorit të përgjithshëm të Arkivave do të ushtrohen për periudhën nga data 21.11.2022 deri në datën 25.11.2022.

3. Nuk delegohen kompetencat e drejtuesit lidhur me personelin, si dhe kompetencat e tjera të padelegueshme, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

4. Për veprimet e kryera në zbatim të këtij urdhri, drejtori i Inspektimit dhe Trajnimeve do të ruajë kopje të kartelave shoqëruese të praktikave shkresore, të iniciuara apo të përfunduara prej tij, së bashku me afatet e përcaktuara dhe ecurinë e mbarëvajtjes e çështjeve dhe do t’ia bëjë të ditura titullarit me rikthimin e tij në detyrë.

5. Për zbatimin e urdhrit ngarkohet drejtori i Inspektimit dhe Trajnimeve, z. Endrit Musaj.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM**Ardit Bido****VENDIM****Nr. 26, datë 27.10.2022****NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Marsida Xhaferllari	kryesuese e seancës;
Altin Binaj	anëtar;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Elsa Toska	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, në datat 23.6.2022 dhe 27.10.2022, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 1(V) 2020 të Regjistrat Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: Vjosa Bodo (Mujo)

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

Presidenti i Republikës së Shqipërisë

Kuvendi i Shqipërisë

Avokati i Popullit

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 69, datë 10.8.2020, të Gjykatës Administrative të Apelit, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 6/1, 15, pika 1, 17, 18, 23, pika 1, 35, pika 3, 42, 49, pika 1, 59, pika 1, 131, pika 1, shkronja “F”, 134, pika 1, shkronja “I” dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 115/2016, datë 3.11.2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 115/2016*); ligji nr. 49/2012, datë 3.5.2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*); ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Elsa Toska, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuases, e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjekteve të interesuara, Presidentit të Republikës së Shqipërisë (*Presidenti*) dhe Avokatit të



Popullit, i cili kërkoi rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e parashtrimeve me shkrim të subjekteve të interesuara, Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (KED) dhe Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. **Kërkuesja** Vjosa Bodo (Mujo) ka shprehur interesin dhe ka kandiduar për vendin vakant (vakancë e parakohshme) në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), të shpallur nga Presidenti në datën 7.2.2018 dhe të rishpallur në datën 27.9.2019, si dhe për vendin vakant (vakancë e parakohshme) në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Kuvendi në datën 28.8.2018 dhe të rishpallur në datën 21.8.2019.

2. Pas përfundimit të procedurës së verifikimit dhe shqyrtimit të kandidaturës së saj, me vendimet nr. 17, datë 17.7.2020 dhe nr. 18, datë 17.7.2020, KED-ja ka vendosur ndalimin e kandidimit të kërkueses për vendet vakante të lartpërmendura.

3. Në datën 4.8.2020 kërkuesja i ka ankimuar vendimet e mësipërme të KED-së në Gjykatën Administrative të Apelit, e cila, me vendimin nr. 69, datë 10.8.2020, ka vendosur rrëzimin e padisë së saj si të pambështetur në prova e ligj.

4. Në datën 10.10.2020 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, sipas objektit.

5. Në datën 16.11.2020 një nga gjyqtaret kushtetuese ka paraqitur kërkesë për heqjen dorë nga shqyrtimi i çështjes për shkak të dhënies së mendimit dhe votimit si anëtare e KED-së për vitin 2020 në lidhje me kandidimin e kërkueses për vendet vakante (vakanca të parakohshme) në Gjykatën Kushtetuese, ndërsa në datën 11.1.2021, për të njëjtat shkaqe, ka paraqitur kërkesë për heqjen dorë nga shqyrtimi i çështjes edhe një gjyqtare tjetër. Me vendimet e datës 12.1.2021, Mbledhja e Gjyqtarëve ka pranuar kërkesat e gjyqtareve për heqjen dorë nga shqyrtimi i çështjes. Në vijim, për shqyrtimin e kësaj çështjeje është caktuar një kolegji i veçantë, i cili në datën 19.1.2021 ka vendosur kalimin e kërkesës për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve.

6. Gjykata vë në dukje se në kushtet e dorëheqjes së dy gjyqtareve kushtetuese, ajo nuk ka pasur kuorumin ligjor të kërkuar nga ligji nr. 8577/2000 për shqyrtimin paraprak të çështjes nga Mbledhja e Gjyqtarëve. Në datat 23.11.2020 dhe 21.1.2021 kërkuesja është vënë në dijeni për mungesën e kuoromit për shqyrtimin paraprak të kërkesës së saj si në kolegji edhe në Mbledhjen e Gjyqtarëve. Kuorumi i kërkuar u bë i mundur me emërimin e gjyqtarit të ri kushtetues dhe në datën 11.4.2022 Mbledhja e Gjyqtarëve vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve, bazuar në nenin 25, pika 5, fjalë e dytë, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, ku parashikohet se në rast barazie të votave vendoset në favor të kalimit të çështjes në seancë plenare.

7. Po kështu, pas përfundimit të mandatit të gjyqtarit Përparim Kalo në datën 8.4.2022 dhe ndërprerjes së marrëdhënieve si gjyqtar në datën 3.6.2022, Gjykata përsëri nuk ka pasur kuorumin e nevojshëm ligjor të kërkuar nga neni 32, pika 1, i ligjit nr. 8577/2000 për shqyrtimin e çështjes konkrete në seancë plenare. Në seancën e datës 23.6.2022, si rrjedhojë e pamundësisë për formimin e kuoromit të nevojshëm prej 6 gjyqtarësh për gjykimin e çështjes, të parashikuar nga neni 32, pika 1, i ligjit nr. 8577/2000, Gjykata vendosi shtyrjen e seancës deri në formimin e këtij kuorumi.

8. Në vijim, në datën 26.9.2022 është emëruar edhe një gjyqtar i ri kushtetues, çka ka bërë të mundur arritjen e kuoromit të nevojshëm për shqyrtimin e çështjes në seancë plenare.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

9. **Kërkuesja** ka pretenduar, në mënyrë të përmblodhur, se i janë cenuar:

9.1 *E drejta për proces të rregullt ligjor*, në drejtim të:

9.1.1 *Së drejtës së aksesit substancial*, pasi Gjykata Administrative e Apelit ka refuzuar të zbatojë ligjin gjatë kontrollit gjyqësor të procesit administrativ, të administrojë e interpretojë provat dhe faktet e çështjes në mënyrë të ligjshme, duke ushtruar pushtetin gjyqësor në kundërshtim me Kushtetutën dhe ligjin.

9.1.2 *Parimit të kontradiktoritetit*, pasi kërkuesja nuk është njoftuar për procedurat e ndjekura ose aktet e përpiluara nga KED-ja dhe as ky organ, as



Gjykata Administrative e Apelit nuk i kanë mundësuar njohjen me aktet dhe rezultatet e nxjerra për kandidimin e saj ose me faktet dhe provat e administruara nga KED-ja, përfshirë edhe procesverbalin e seancës së datës 17.7.2020, duke i mohuar të drejtën për t'u rivlerësuar dhe për të diskutuar mbi bazë kontradiktoriteti gjetjet dhe provat gjatë gjykimit administrativ.

9.1.3 Vendimet e KED-së janë marrë në shkelje të parimeve të hetimit administrativ, bashkëpunimit gjatë hetimit, kërkimit e vlerësimit të provës dhe metodave për paraqitjen e saj, si dhe të së drejtës për t'u dëgjuar. Kufizimi i të drejtave të saj është bërë pa ligj, si dhe pa u qartësuar interesi publik ose mbrojtja e nevojshme dhe e domosdoshme, që imponon kufizimin e të drejtave dhe lirive kushtetuese.

9.1.4 Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, pasi KED-ja i ka mohuar të drejtën për të paraqitur kërkesë për përjashtimin e anëtares së saj që shfaqte papajtueshmëri, në kushtet kur kjo anëtare kishte deklaruar ekzistencën e konfliktit të interesit me një ndër garuesit e tjerë për të njëjtin pozicion që ka konkurruar edhe kërkuesja. Po kështu, Gjykata Administrative e Apelit ka marrë në mbrojtje interesat e palës së paditur, pasi nuk ka pranuar faktet e parashtruara nga kërkuesja në padi dhe në seancë, për të cilat pala e paditur nuk ka paraqitur asnjë pretendim.

9.1.5 Standardit të arsyetimit të vendimit, pasi KED-ja nuk ka arsyetuar vendimmarrjet e saj në drejtim të kërkesave detyruese të parashikuara nga neni 100 i Kodit të Procedurave Administrative (KPA). Relacioni i përgatitur nga gjyqtari relator në KED nuk përmban asnjë paraqitje të veprimeve procedurale të kryera prej tij në drejtim të hetimit administrativ për eksperiencat e punës së kërkueses. Në vendimin e saj Gjykata Administrative e Apelit nuk ka përmendur provat e administruara dhe arsyet mbi të cilat ka mbështetur vendimin e saj, si dhe nuk ka arsyetuar për pretendimin e kërkueses për pamundësinë e përjashtimit të anëtarit të KED-së. Vendimi i kësaj gjykate nuk është i arsyetuar, pasi në tërësinë e tij përmenden pretendimet e kërkueses, palës së paditur dhe palës së tretë. Gjykata nuk ka renditur rrethanat e çështjes, siç janë konstatuar gjatë gjykimit, dhe nuk ka përmendur provat e administruara ose arsyet mbi të cilat ka mbështetur

vendimin. Sipas kërkueses, vetëm citimi i ligjit nuk zëvendëson mënyrën origjinale të arsyetimit.

9.1.6 Së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, pasi procedura administrative e KED-së ka përfunduar tej çdo afati ligjor e të arsyeshëm, si dhe në mohim të së drejtës për të pasur një vendim të arsyetuar brenda afatit 3-ditor të përcaktuar në pikën 46 të vendimit nr. 4, datë 11.3.2019, të KED-së, "Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë" (vendimi nr. 4/2019).

9.2 E drejta për të fituar mjetet e jetesës me punë të ligjshme, e parashikuar në nenin 49, pika 1, të Kushtetutës, konkretisht e drejta për të garuar për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese e për t'u emëruar në një funksion publik në një organ kushtetues; e drejta e kualifikimit profesional, në drejtim edhe të integritetit, pasi ajo e plotëson kriterin 15-vjeçar të përvojës së punës që duhet për t'u zgjedhur anëtar i kësaj Gjykate.

9.3 E drejta për t'u njohur me të dhënat personale, e garantuar nga neni 35 i Kushtetutës, pasi Gjykata Administrative e Apelit, në heshtje, i ka mohuar të drejtën për të pasur informacion për të dhënat e mbledhura rreth saj në procedimin administrativ të ndjekur nga KED-ja.

9.4 Parimi i barazisë para ligjit dhe mosdiskriminimit, pasi në vendime të ngjashme për të tjerë garues KED-ja ka mbajtur qëndrim të ndryshëm kualifikues dhe jo ndalues.

9.5 Kërkuesja ka kërkuar, gjithashtu, gjykimin përfundimtar të ankimit kushtetues individual të saj, përmes interpretimit përfundimtar të një sërë dispozitash kushtetuese dhe ligjore.

10. Subjekti i interesuar, Presidenti, ka parashtruar se qëndrimi i tij për çështjen ka gjetur pasqyrim në faqet 47-48 të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit, i cili është administruar si provë nga Gjykata. Në referim të përmbajtjes së këtij vendimi, Gjykata vëren se në gjykimin në Gjykatën Administrative të Apelit, Presidenti ka pretenduar në mënyrë të përmbledhur se:

10.1 Moslejimi i kandidimit të asnjë prej kandidatëve që kanë shprehur interesin për dy vakancat është parë si shqetësues. KED-ja nuk mund të ketë vetëm rolin e certifikuesit ose të relatorit për gjetjet e organeve të tjera prej të cilave merr e mbledh informacion për një kandidat, por mund të kishte bërë një vlerësim të thelluar të



kushteve dhe kriterëve të emërimit. Ky institucion i ka të gjitha mundësitë që, brenda kornizës kushtetuese dhe ligjore, të përcaktojë standarde që do të udhëheqin mënyrën e shqyrtimit të përmbushjes së kriterëve për plotësimin e vakancës nga çdo person që shpreh interes, si dhe procedurën së cilës do t'i nënshtrohen.

10.2 Vetë anëtarët e KED-së nuk janë të qartë për procedurën që duhet të ndjekin dhe mënyrën se kur një kriter quhet i përmbushur ose jo. KED-ja duhet të ketë mundësinë të vlerësojë përvojën e secilit kandidat, përmes interpretimit të normës kushtetuese dhe ligjore për rastet kur një kriter mund të vlerësohet i përmbushur nga kandidati, të përcaktojë një metodologji për kryerjen e vlerësimit të përmbushjes së kushteve, si dhe për shqyrtim të thelluar, duke dalë në përfundim mbi të dhënat që mbledh nga institucionet e tjera dhe jo vetëm të administrojë dosjen e kandidatit. KED-ja ka pranuar *a priori* dokumentet e institucioneve të treta, ndërkohë ka raste që ka kërkuar edhe mendimin e ekspertëve të pavarur.

10.3 Kandidati në proces shqyrtimi nuk ka pasur mundësi të kundërshtojë gjetjet, duke u përballur me raportet e përgatitura nga institucionet e treta, pa pasur mundësi t'u përcjellë atyre sqarime dhe të kërkojë rishikimin e gjetjeve.

10.4 Vendimet e KED-së nuk kanë reflektuar një proces të mirëfilltë të vlerësimit të kandidaturave, arsyetim e analizë ligjore të plotë për gjetjet e evidentuara, si dhe u mungon arsyetimi shterues. KED-ja më shumë citon fakte dhe shpjegime, sesa një analizë të thelluar të gjetjeve të krahasuar me bazën kushtetuese dhe ligjore.

11. Subjekti i interesuar, Avokati i Popullit, ka parashtruar se:

11.1 Kërkuesja legjitimohet në kërkimin e saj, pasi ka pritshmëri për procedurat e kandidimit për vakancat e reja të shpallura nga Gjykata dhe çështja është në juridiksionin ekskluziv të kësaj Gjykate, pasi asnjë nga gjykatat e pushtetit gjyqësor nuk mund të ketë juridiksion për të.

11.2 Kërkueses nuk i është mohuar e drejta për t'u dëgjuar, pasi gjatë gjithë procedurës administrative, të kryer nga KED-ja, ka marrë dijeni për veprimet procedurale e verifikuese të kryera, si dhe ka ushtruar të drejtën e paraqitjes së pretendimeve ose kërtimeve me shkrim për çdo çështje të dalë gjatë kësaj veprimtarie.

11.3 Pretendimet e parashtruara janë analizuar prej saj nga ana ligjore, në mungesë pothuajse të plotë të argumenteve kushtetuese. Shkeljet e pretenduara kanë të bëjnë me interpretimin, kuptimin dhe zbatimin e ligjit nga KED-ja dhe jo me shkelje të rënda procedurale. Kërkuesja kërkon të zgjerohet rrethin e subjekteve të parashikuara nga Kushtetuta dhe ligji për të kandiduar në vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese, përmes interpretimit të tyre në mënyrë të tillë që i lejon asaj hyrjen në këtë garë. Ajo është e paqartë nëse shkeljet e rënda procedurale kanë të bëjnë me interpretimin e kriterit “përvojë pune” ose me mosdhënien e mundësisë nga KED-ja për të provuar periudhat dhe përvojat e punës.

11.4 Ligjvënësi nuk ka përcaktuar afat kohor për shqyrtimin e kandidaturave nga KED-ja dhe vlerësimi i procesverbalit audio i përket gjykatës administrative, e cila e vlerëson atë së bashku me provat e tjera. Vlerësimi i provave të paraqitura dhe të administruara në procedurën administrative është e drejtë e organit publik që kryen procedurën.

11.5 Pretendimet e kërkueses për mungesën e arsytimit të vendimeve të KED-së dhe të Gjykatës Administrative të Apelit janë haptazi të pabazuara. Gjykata Administrative e Apelit i ka dhënë përgjigje çdo pretendimi të saj.

11.6 Duke i trajtuar pretendimet e saj për procesin e rregullt ligjor në drejtim të së drejtës së mbrojtjes, vlerësohet se ato kanë mbetur në nivel kërkimi të paargumentuar dhe të paprovuar. Kërkuesja nuk ka arritur të provojë se si, gjatë procedurës së verifikimit të përvojës së punës në procesin administrativ e më pas atë gjyqësor, është vendosur në pozitë të tillë që e ka bërë të pamundur realizimin e kësaj të drejte.

11.7 Për sa i përket pretendimit për cenimin e së drejtës për mosdiskriminim, për shkak të qëndrimit të mbajtur ndaj saj nga KED-ja, nuk rezulton që kërkuesja t'i jetë drejtuar Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

11.8 Kushtet ligjore të parashikuara në pikën 4 të nenit 125 të Kushtetutës dhe në pikën 2 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000 janë proporcionale, të nevojshme në një shoqëri demokratike dhe përbëjnë një kufizim të arsyeshëm, në përputhje me nenin 17 të Kushtetutës. Përfshirja e kriterit të përvojës 15-vjeçare të punës nuk e cenon procesin, përkundrazi e bën atë më parimor, të besueshëm dhe objektiv.



11.9 Dispozitat kushtetuese dhe ligjore, për të cilat kërkuesja ka kërkuar interpretimin përfundimtar nga Gjykata, janë të qarta e nuk lënë shteg për kuptime të ndryshme. Ajo nuk ka arritur të provojë se zbatimi i tyre në praktikë ka qenë i pamundur ose ka sjellë vështirësi. Kriteret ligjore të përcaktuara në nenin 125 të Kushtetutës dhe pikën 2 të nenit 7/a, të ligjit nr. 8577/2000, janë në përputhje me nenin 17 të Kushtetutës.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuësës

12. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2 të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

13. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

14. Kriteret për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative, pra duhet të plotësohen njëkohësisht. Në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

15. Kërkuesja, si individ, legjitimohet *ratione personae* në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2 të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor, për të cilin ka ngritur pretendimet në Gjykatë, ndaj provon interesin e drejtpërdrejtë në këtë çështje.

16. Në lidhje me *shterimin e mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës, individ mund t’i drejtohet Gjykatës

për cenimin e të drejtave kushtetuese, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike, çka nënkupton që ai duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete. Shterimi i mjeteve përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuesja, e cila para se t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese duhet të vërtetojë se ka përdorur të gjitha mjetet juridike të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura (*shih vendimet nr. 4, datë 21.2.2022; nr. 38, datë 2.12.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Ky rregull nënkupton jo vetëm që individ t’u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t’i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 19, datë 7.7.2022; nr. 12, datë 9.3.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Gjykata vëren se kërkuesja ka kërkuar shfuqizimin e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit që ka vendosur përfundimisht për skualifikimin e saj nga kandidimi në procedurat për dy vakancat në Gjykatën Kushtetuese dhe pretendimet e saj për cenimin e të drejtave kushtetuese i ka ngritur, në thelb, në atë gjykatë, vendimi i së cilës ka përmbysllur procesin gjyqësor për shqyrtimin e themelit të çështjes. Në këto kushte, Gjykata vlerëson të theksojë paraprakisht natyrën juridike të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit, që shqyrton dhe vendos ndaj një vendimi të KED-së përmes të cilit është ndaluar kandidimi për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese, konkretisht nëse ai është ose jo përfundimtar.

18. Neni 238 i ligjit nr. 115/2016 parashikon se ndaj vendimeve të KED-së që ndalojnë kandidimin lejohet ankimi vetëm për shkelje të rënda procedurale. Ankimi paraqitet në Gjykatën Administrative të Apelit jo më vonë se 5 ditë nga dita e njoftimit të vendimit të kundërshtuar. Gjykata Administrative e Apelit vendos brenda 7 ditëve nga dita e dorëzimit të ankimit dhe vendimi i saj është përfundimtar dhe i formës së prerë (*shih pikat 1 dhe 2, të nenit 238, të ligjit nr. 115/2016*).

19. Bazuar në parashikimin e mësipërm, Gjykata vëren se juridiksioni gjyqësor për rastet e ankimit ndaj vendimeve të KED-së, që ndalojnë kandidimin për plotësimin e vendeve vakante për



gjqtarë në Gjykatën Kushtetuese, është i kufizuar. Në këto raste Gjykata Administrative e Apelit vlerëson vetëm nëse gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të kandidaturave nga KED-ja janë kryer shkelje të rënda të procedurës, ndërsa përcaktimi i natyrës përfundimtare dhe formës së prerë të këtij vendimi për këto raste, e bën atë të paankimueshëm në një gjykatë më të lartë. Në këtë kuptim, vendimet e kësaj natyre janë përfundimtare dhe ndaj tyre nuk mund të ushtrohet rekurs nga palët.

20. Duke parashikuar vetëm një shkallë ankimi, ligjvënësi ka pasur në vëmendje prioritetin e plotësimit të vendeve vakante në Gjykatën Kushtetuese, në kuadrin e funksionimit të këtij institucioni kushtetues. Në këtë drejtim, duke pasur parasysh rolin dhe funksionin e saj si garante e Kushtetutës, Gjykata vlerëson se qëllimi i ligjvënësit në përcaktimin e vetëm një shkalle gjykimi ndaj vendimeve të KED-së, që vendosin ndalimin e kandidimit, i përgjigjet nevojës për të mos krijuar zvarritje/vonesa për plotësimin e vendeve vakante në një institucion të rëndësishëm kushtetues siç është Gjykata Kushtetuese. Nga ana tjetër, Gjykata thekson se KED-ja, për sa i përket formimit, organizimit, si dhe mënyrës së funksionimit, është organ kushtetues i pavarur, *quasi* gjyqësor, me kompetenca të njohura nga Kushtetuta (neni 149/d), që kryen verifikimin e përmbushjes së kushteve ligjore dhe vlerëson kriteret profesionale e morale të kandidatëve për vendet vakante për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese dhe për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë. Në lidhje me ankimet kundër vendimit të KED-së për ndalimin e kandidimit vetëm për shkelje të rënda procedurale, ankimi në Gjykatën Administrative të Apelit konsiderohet si ankim në një gjykatë më të lartë, në kuptim të nenit 43 të Kushtetutës.

21. Gjykata rithekson se përfundimi i procesit në Gjykatën Administrative të Apelit nuk cenon të drejtën për një proces të rregullt ligjor, pasi shteti nuk ka detyrim të parashikojë më shumë se një shkallë ankimi, për sa kohë që ka një ankim në një gjykatë të parashikuar me ligj, në kuptim të nenit 43 të Kushtetutës, si dhe nenit 13 të KEDNJ-së (*shih vendimin nr. 1, datë 16.1.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Ky qëndrim është pranuar edhe nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), e cila ka theksuar rëndësinë e ushtrimit të kontrollit gjyqësor ndaj çdo vendimi të organeve që

vlerësojnë kandidaturat, përzgjedhin dhe vendosin për karrierën e gjyqtarëve, ose të paktën të procedurës sipas së cilës merret një vendim i tillë. Megjithatë, e drejta e aksesit në gjykata nuk është absolute dhe ajo mund të jetë objekt i kufizimeve, me kusht që të mos cenohet thelbi i së drejtës. Një kufizim nuk do të jetë në përputhje me nenin 6 § 1 nëse nuk ndjek një qëllim legjitim dhe nëse nuk ka një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të arrihet (*shih vendimin e GJEDNJ-së në çështjen Gloveli kundër Gjeorgjisë, datë 7.4.2022, §§ 51 dhe 57*).

22. Duke iu rikthyer çështjes konkrete, Gjykata vëren se neni 238 i ligjit nr. 115/2016 garanton të drejtën e ankimit, të drejtë të cilën kërkesja e ka ushtruar lirisht në Gjykatën Administrative të Apelit, që ka mbajtur qëndrim për pretendimet e saj. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se parashikimi i së drejtës së ankimit gjyqësor ndaj vendimit të KED-së në Gjykatën Administrative të Apelit, vendimi i së cilës është përfundimtar dhe i formës së prerë, nuk cenon standardin kushtetues të së drejtës së ankimit, të parashikuar në nenin 43 të Kushtetutës.

23. Për sa më lart, në kushtet kur legjislacioni në fuqi nuk parashikon ushtrimin e rekursit në Gjykatën e Lartë ndaj vendimit nr. 69, datë 10.8.2020, të Gjykatës Administrative të Apelit objekt kërkesë, Gjykata vlerëson se kërkesja ka plotësuar kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive përpara se t'i drejtohet kësaj Gjykate.

24. Në lidhje me legjitimitimin *ratione temporis*, Gjykata vëren se kërkesja kundërshton vendimin nr. 69, datë 10.8.2020, të Gjykatës Administrative të Apelit, i cili, në zbatim të nenit 238, të ligjit nr. 115/2016, është përfundimtar dhe i formës së prerë, ndërsa ankimi kushtetues individual për kundërshtimin e këtij vendimi është depozituar në datën 10.10.2020, pra brenda afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja "b", i ligjit nr. 8577/2000.

25. Në drejtim të legjitimitimit *ratione materiae*, kërkesja ka pretenduar se proceset e zhvilluara nga KED-ja dhe Gjykata Administrative e Apelit i kanë cenuar të drejtën për të siguruar mjetet e jetesës me punë të ligjshme, të drejtën për t'u njohur me të dhënat personale, parimin e barazisë para ligjit dhe mosdiskriminimit, si dhe të drejtën për një proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës për akses substancial, parimit të kontradiktoritetit, së drejtës



për t'u dëgjuar, së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, standardit të arsyetimit të vendimit, së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, si dhe ka kërkuar interpretimin përfundimtar të një sërë dispozitash kushtetuese e ligjore.

26. Në këndvështrim të legjitimitetit *ratione materiae*, Gjykata thekson se në nenin 71/a, pika 1, shkronja “ç”, të ligjit nr. 8577/2000 parashikohet si kriter tjetër në shqyrtimin e ankimit kushtetues individual edhe se shqyrtimi i çështjes nga Gjykata do të mund të rivendoste në vend të drejtën e pretenduar të shkelur të individit. Për sa i përket vlerësimit të këtij kriteri në rastin e kërkuar, në përfundim të diskutimeve, në zbatim të nenit 72, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, Gjykata nuk arriti numrin e kërkuar të votave për vendimarrje, sipas parashikimeve të nenit 133, pika 2, të Kushtetutës, të detajuar edhe në nenin 72, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000.

27. Kështu, sipas njërit qëndrim u vlerësua se kërkuarja legjitimohet *ratione materiae* në kërkesën drejtuar Gjykatës, pasi pretendimet e ngritura në ankimin kushtetues bëjnë pjesë në juridiksionin dhe kompetencën e Gjykatës, e cila, në rastin e ankimit kushtetues individual, shqyrton pretendimet për gjykimet përfundimtare, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese. Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore përfundimtare, në rastet kur ankuesi është gjyqumbës, nuk përbën pamundësi për rivendosjen në vend të të drejtave kushtetuese të shkelura, për rrjedhojë nuk është shkak për mospranimin e ankimit kushtetues individual. Në këtë analizë, plotësimi nga organet e emërtesës në dhjetor të vitit 2020 të vendeve vakante, për të cilat kërkuarja ka qenë në proces verifikimi në KED, si dhe fillimi i procedurës së radhës për të njëjtat pozicione, nuk përbëjnë “*pamundësi të rivendosjes në vend të të drejtave kushtetuese të kërkuarës nga shqyrtimi i çështjes kushtetuese nga Gjykata*”, në kuptim të juridiksionit dhe kompetencës lëndore të saj sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës dhe nenit 71/a, pika 1, shkronja “ç”, të ligjit nr. 8577/2000.¹

28. Sipas qëndrimit tjetër u vlerësua se në zbatim të nenit 71/a, pika 1, shkronja “ç”, të ligjit

nr. 8577/2000, shqyrtimi i çështjes nga Gjykata nuk do të rivendoste në vend të drejtat që kërkuarja pretendon se i janë shkelur. Vendet vakante për të cilat kërkuarja ka qenë kandidate dhe në proces verifikimi në KED janë plotësuar me dy gjyqtarë kushtetues, të emëruar përkatësisht nga Presidenti dhe Kuvendi, të cilët kanë filluar ushtrimin e detyrës në muajin dhjetor të vitit 2020. Për më tepër, Gjykata, bazuar në nenin 127, pikat 1, shkronja “b”, 2 dhe 3, të Kushtetutës, si dhe nenet 8, pika 3 dhe 9, pikat 1, shkronja “b” dhe 2, të ligjit nr. 8577/2000, me vendimet nr. 41, datë 22.12.2021 dhe 42, në datën 22.12.2021, ka deklaruar mbarimin e mandatit të këtyre gjyqtarëve, duke iniciuar kështu edhe procedurën e zëvendësimit të tyre nga organet e emërtesës. Një ndër mënyrat se si mund të rivendoset në vend e drejta e pretenduar e cenuar është nëpërmjet vendimarrjes së Gjykatës për shfuqizimin e vendimeve objekt kundërshtimi si të papajtueshme me Kushtetutën dhe rikthimin e çështjes për rishqyrtim në gjykatën përkatëse ose konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese, duke i “detyruar” organet të veprojnë në mënyrën më efektive për të rivendosur në vend të drejtën kushtetuese. Në këtë këndvështrim, shqyrtimi i pretendimeve të paraqitura nga kërkuarja përmes ankimit kushtetues individual dhe shfuqizimi i vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit nuk do të sillnin rezultate konkrete në drejtim të rivendosjes në vend të së drejtës së pretenduar të cenuar.²

29. Për sa më lart, Gjykata vëren se në kushtet kur nuk u formua shumica prej 5 gjyqtarësh, në kuptim të nenit 73, pika 4, të ligjit nr. 8577/2000, kërkesa e kërkuarës konsiderohet e rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 133, pika 2, të Kushtetutës, si dhe neneve 71, 72 dhe 73, pika 4, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

¹ Votuan për legjitimitetin *ratione materiae* të kërkuarës gjyqtarët Marsida Xhaferllari, Sonila Bejtja dhe Ilir Toska.

² Votuan për moslegjitimitetin *ratione materiae* të kërkuarës gjyqtarët Elsa Toska, Altin Binaj dhe Sandër Beci



VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 27.10.2022.

Shpallur më 18.11.2022.

Kryesuese: Marsida Xhaferllari

Anëtarë: Sonila Bejtja, Altin Binaj, Elsa Toska, Ilir Toska, Sandër Beci

VENDIM

Nr. 27, datë 27.10.2022

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Marsida Xhaferllari	kryesuese e seancës;
Elsa Toska	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Altin Binaj	anëtar,

me sekretare Belma Lleshi, në datën 27.10.2022, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 5 (S) 2021 të Regjistrat Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Shaqir Hasanaj

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

Avokati i Popullit

Presidenti i Republikës së Shqipërisë

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 102, datë 9.12.2020, të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 46, datë 26.11.2020, të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Konstatimi i shkeljes së neneve 6, pika 1 dhe 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

BAZA LIGJORE: Nenet 131, pika 1, shkronja “P”, 134, pika 1, shkronja “I” dhe 134, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 6, pika 1 dhe 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ); nenet 71/a dhe 76 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe

funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Altin Binaj, shqyrtoi pretendimet e kërkuarit, i cili kërkoj pranimin e kërkesës, parashtrimet e subjektit të interesuar, Avokatit të Popullit, që kërkoj rrëzimin e kërkesës, qëndrimin e subjektit të interesuar, Presidentit të Republikës së Shqipërisë (Presidenti), konstatoi mungesën e parashtrimeve të subjektit të interesuar, Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (KED), si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuari Shaqir Hasanaj (kërkuari) ka shprehur interesin për kandidimin në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, pasi Presidenti, me dekretin nr. 10723, datë 7.2.2018, ka miratuar shpalljen e procedurës së aplikimit për emërimin e gjyqtarit në Gjykatën Kushtetuese, të cilën e ka rishpallur me dekretet e datave 27.9.2019 dhe 24.9.2020.

2. Me vendimin nr. 4, datë 11.3.2019, “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë” të KED-së kërkuari është njoftuar për të vijuar me përmbushjen e procedurave të verifikimit të kandidaturës. Në datën 27.10.2020 ai ka depozituar formularët e deklaratimit dhe autorizimet përkatëse me qëllim vijimin e procedurës së verifikimit të kandidaturës.

3. KED-ja, me vendimin nr. 46, datë 26.11.2020, ka vendosur ndalimin e kandidimit të kërkuarit Shaqir Hasanaj për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese. KED-ja ka arsyetuar se me vendimin nr. 37, datë 25.5.1999 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë (KLD), kërkuari është larguar nga detyra e gjyqtarit, pasi ndaj tij është marrë masa disiplinore “Shkarkim nga detyra”. Për këtë shkak, ai nuk i plotëson kushtet ligjore të parashikuara nga neni 7/a, pika 1, shkronja “d”, i ligjit nr. 8577/2000 si kandidat për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese.



4. Kërkuesi kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, e cila, me vendimin nr. 102, datë 9.12.2020, ka vendosur rrëzimin e ankimit.

5. Në datën 9.4.2021 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me kërkesë për shfuqizimin e vendimeve objekt kërkesë. Kolegji i Gjykatës në datën 1.6.2021 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve. Për shkak të heqjes dorë nga shqyrtimi i çështjes të dy gjyqtareve, të cilat kanë qenë anëtare të KED-së kur është shqyrtuar çështja, Mbledhja e Gjyqtarëve nuk ka pasur kuorumin e nevojshëm ligjor për shqyrtimin e saj. Me plotësimin e kuoromit, Mbledhja e Gjyqtarëve në datën 11.4.2022, bazuar në nenin 25, pika 5, fjalia e dytë, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve. Pas përfundimit të mandatit të një tjetër gjyqtari në datën 8.4.2022 dhe ndërprerjes së marrëdhënieve si gjyqtar në datën 3.6.2022, Gjykata Kushtetuese përsëri nuk ka pasur kuorumin e nevojshëm ligjor të kërkuar nga neni 32, pika 1, i ligjit nr. 8577/2000, për shqyrtimin e çështjes konkrete në seancë plenare. Konkretisht, në seancën e datës 23.6.2022, si rrjedhojë e pamundësisë për formimin e kuoromit të nevojshëm prej 6 gjyqtarësh për gjykimin e çështjes, të parashikuar nga neni 32, pika 1, i ligjit nr. 8577/2000, Gjykata ka vendosur shtyrjen e seancës deri në formimin e kuoromit. Me plotësimin e kuoromit ligjor u bë e mundur marrja në shqyrtim e kësaj çështjeje.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

6. Kërkuesi ka parashtruar, në mënyrë të përmbledhur, se gjatë shqyrtimit të çështjes në KED dhe Gjykatën Administrative të Apelit është cenuar:

6.1 *Parimi i mosdiskriminimit dhe barazisë para ligjit*, pasi është gjykuar me dy standarde, si ish-këshilltar i Presidentit të Republikës së Shqipërisë, pavarësisht se ka qenë në pozita të barabarta me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë.

6.2 *E drejta për jetë familjare dhe profesionale*, e garantuar nga neni 8 dhe Protokollin nr. 12 i KEDNJ-së, pasi është përjashtuar nga rrethi i

juristëve të nivelit të lartë. Protokollin nr. 12 i KEDNJ-së siguron mbrojtje të gjerë kundër diskriminimit duke u zbatuar edhe në çështjet e punës.

6.3 *E drejta për t'u dëgjuar dhe parimi i kontradiktoritetit*, pasi KED-ja nuk e ka pranuar kërkesën për t'u dëgjuar për pretendimet e tij në kundërshtim me nenin 33 të Kushtetutës dhe nenin 109 të Kodit të Procedurave Administrative.

6.4 *Parimi i sigurisë juridike*, pasi ka pasur pritshmëri për t'u përfshirë në garë, duke marrë në konsideratë që një organ tjetër kolegjal në të njëjtat kushte e kishte kualifikuar, pavarësisht se nuk u përzgjedh dhe nuk u votua për gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Vendimi nr. 37, datë 25.5.1999 i ish-KLD-së ka si bazë ligjore një dispozitë të deklaruar si antikushtetuese me vendimin nr. 3, datë 20.2.2006, të Gjykatës Kushtetuese, me të cilin është shfuqizuar pika 6 e nenit 42 të ligjit nr. 8436, datë 28.12.1998, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë". Gjithashtu, ky parim është cenuar, pasi KED-ja ka pranuar faktin se është larguar me vendim të ish-KLD-së dhe nuk ka pranuar faktin se po ky institucion e ka kualifikuar si kandidat për gjyqtar në vitin 2016. Ndaj kërkuesit konsiderohet se nuk ka asnjë masë disiplinore në fuqi, pasi bazuar në nenin 76, pika 7, shkronja "c", të ligjit nr. 8577/2000 vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 3, datë 20.2.2006 ka fuqi prapavepruese ndaj pasojave ende të paezauruara të ligjit ose aktit normativ të shfuqizuar. Sipas vendimit për marrjen e masës disiplinore të vitit 1999 të ish-KLD-së, kërkuesit i ndalohet të ushtrojë detyrën e gjyqtarit deri vitin 2029, moment i daljes në pension, pra ende nuk janë ezauruar pasojat.

6.5 Vendimi nr. 46, datë 26.11.2020 i KED-së ka shkaqe absolutisht dhe relativisht të pavlefshme, të cilat përbëjnë shkelje të rënda procedurale. Nga anëtarët e KED-së është çmuar ndalimi i kandidimit si gjyqtar, duke u bazuar në një masë disiplinore të marrë para 21 vjetësh, për të cilën është shkarkuar nga detyra e gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. KED-ja ka shkelur ligjin dhe ka lejuar shkelje të rënda procedurale duke mos kryer hetimin administrativ për informacionin dhe dokumentacionin e cunguar të përcjellë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, si dhe nuk është respektuar procedura sipas kreut 10 të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative".



Gjithashtu, Gjykata Administrative e Apelit ka cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor, pasi nuk e ka konsideruar hetimin e cunguar administrativ, mosmarrjen e provave, si dhe mohimin e së drejtës për t'u dëgjuar, shkelje procedurale.

7. Subjekti i interesuar, Avokati i Popullit, ka prapësuar si vijon:

7.1 *Për juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese:*

7.1.1 Gjykata Kushtetuese nuk ka juridiksion për të shqyrtuar vendimin nr. 46, datë 16.11.2020 të KED-së, pasi bazuar në nenin 238 të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” (*ligji nr. 115/2016*) juridiksionin për të vlerësuar ligjshmërinë e këtij vendimi e ka vetëm Gjykata Administrative e Apelit. Kjo pjesë e kërkesës së paraqitur në Gjykatë ka të bëjë vetëm me ligjshmërinë e aktit administrativ të nxjerrë nga KED-ja dhe jo me pajtueshmërinë e tij.

7.2 Pretendimi i kërkuarit për të shfuqizuar vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit, duke lejuar vazhdimin e procedurës, është i pabazuar në ligj. Vendimi është përfundimtar dhe i formës së prerë, dhe paraqitja e tij nuk pezullon procedurat në zhvillim në KED.

7.3 Rikthimi i çështjes për rishqyrtim si mënyrë për rivendosjen e së drejtës në vend, nuk respekton *parimin e proporcionalitetit*, pasi në këtë proces interesi publik për funksionalitetin e Gjykatës është shumë i lartë në raport me interesin vetjak të kandidatit.

7.4 Pretendimet e parashtruara nga kërkuari lidhen me zbatimin e ligjit nga ana e gjykatës për zgjidhjen e themelit të çështjes dhe mungon paraqitja e argumenteve për shkeljet kushtetuese.

7.5 Për pretendimin për cenimin e *parimit të mosdiskriminimit*, mungojnë argumentet në nivel kushtetues dhe për të provuar lidhjen me nenin 14 të KEDNJ-së. Kërkuari nuk ka provuar ardhjen e pasojave në jetën private që lidhen me mirëqenien e tij, të familjes ose reputacionit shoqëror dhe profesional.

7.6 Kërkuari nuk ka parashtruar asnjë argument në nivel kushtetues për të provuar *cenimin e së drejtës për jetë familjare dhe private* ose cilat kanë qenë masat shtetërore që kanë ndikuar ose cenuar këtë të drejtë.

7.7 Kërkuarit nuk i është mohuar *e drejta për t'u dëgjuar*, pasi gjatë të gjithë procedurës administrative të zhvilluar nga KED-ja ka marrë dijeni për veprimet procedurale dhe verifikuese, si dhe ka

ushtruar të drejtën për të paraqitur parashtrime e kërtime me shkrim për çdo çështje.

7.8. Pretendimi i kërkuarit për cenimin e *parimit të sigurisë juridike* është i pabazuar. Vendimi i KED-së është një akt administrativ individual i nxjerrë nga një organ i parashikuar shprehimisht në Kushtetutë. Pritshmëritë e palës pjesëmarrëse në një procedurë administrative nuk duhet të barazohen me vendimarrjen e ligjshme dhe në respektim të Kushtetutës të organeve të parashikuara shprehimisht në Kushtetutë.

8. Subjekti i interesuar, Presidenti, paraqiti qëndrimin se Gjykata Kushtetuese, për shkak të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, është në dijeni të rastit konkret. Presidenti, përmes përfaqësuesve të autorizuar, ka shprehur qëndrimin në mbledhjet e KED-së gjatë vitit 2020 për procedurat e ndjekura nga KED-ja dhe mënyrën e procedimit në procesin e plotësimit të kësaj vakance të parakohshme.

9. Subjekti i interesuar, KED-ja, edhe pse është njoftuar rregullisht nuk ka paraqitur parashtrime me shkrim.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese

10. Subjekti i interesuar, Avokati i Popullit, ka parashtruar se Gjykata nuk ka juridiksion për të shqyrtuar vendimin nr. 46, datë 16.11.2020 të KED-së, pasi bazuar në nenin 238 të ligjit nr. 115/2016 juridiksionin për të vlerësuar ligjshmërinë e vendimit e ka vetëm Gjykata Administrative e Apelit. Kjo pjesë e kërkesës së paraqitur në Gjykatë ka të bëjë vetëm me ligjshmërinë e aktit administrativ të nxjerrë nga KED-ja dhe jo me shqyrtimin e pajtueshmërisë së tij me Kushtetutën.

11. Gjykata vëren se bazuar në nenin 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës ka në juridiksionin e saj gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e këtyre të drejtave. Jurisprudenca kushtetuese ka pohuar se Gjykata në përputhje me kompetencat e përcaktuara nga Kushtetuta, e përcakton vetë juridiksionin e saj gjatë shqyrtimit të çështjeve, rast pas rasti (*shih vendimet nr. 17, datë 30.3.2021; nr. 4,*



datë 15.2.2021, të Gjykatës Kushtetuese). Megjithatë, detyra e Gjykatës nuk është zgjidhja e një mosmarrëveshjeje juridike për çështje fakti, por identifikimi i fakteve të natyrës kushtetuese, të cilat shërbejnë për realizimin e kompetencave të saj dhe përbëjnë elementin thelbësor në përcaktimin e autoritetit të një gjykimi kushtetues (*shih vendimet nr. 63, datë 31.7.2017; nr. 3, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në rastin konkret, Gjykata, duke marrë në konsideratë se kërkuar respektimin e zbatimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, vlerësimi i së cilës është në juridiksionin e Gjykatës, çmon se pretendimi i subjektit të interesuar, Avokatit të Popullit, është i papabuar.

B. Për legjitimitimin e kërkuar

13. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me iniciimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P”, 134, pika 1, shkronja “I” dhe 134, pika 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

14. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur. Këto kriteret janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuar të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues. Në mbështetje të këtij kuadri kushtetues do të vlerësohet legjitimitimi i kërkuar, duke analizuar me radhë kriteret e pranueshmërisë së kërkesës.

15. Gjykata vlerëson se kërkuar, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, sepse është palë në vendimet objekt kundërshtimi dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen konkrete.

16. Në lidhje me *shterimin e mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të

Kushtetutës, individ mund t'i drejtohet Gjykatës për cenimin e të drejtave kushtetuese, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike, çka nënkupton që ai duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete. Shterimi i mjeteve përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuar, i cili para se t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese duhet të vërtetojë se ka përdorur të gjitha mjetet juridike të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura (*shih vendimin nr. 4, datë 21.2.2022, të Gjykatës Kushtetuese*). Ky rregull nënkupton jo vetëm që individ t'u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t'i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimin nr. 12, datë 9.3.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Gjykata vlerëson të shqyrtojë paraprakisht nëse vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit, që ka lënë në fuqi vendimin e KED-së, përmes të cilit është vendosur ndalimi i kandidimit për vendet vakante për gjyqtarë në Gjykatën Kushtetuese, është i natyrës përfundimtare.

18. Gjykata vëren se në zbatim të nenit 238 të ligjit nr. 115/2016 ndaj vendimeve të KED-së për ndalimin e kandidimit lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit vetëm për shkelje të rënda procedurale, i cili paraqitet jo më vonë se 5 ditë nga dita e njoftimit të vendimit të kundërshtuar. Gjykata Administrative e Apelit vendos brenda 7 ditëve nga dita e dorëzimit të ankimit dhe vendimi i saj është përfundimtar dhe i formës së prerë (*shih pikat 1 dhe 2 të nenit 238 të ligjit nr. 115/2016*). Bazuar në këtë parashikim ligjor, Gjykata vëren se juridiksioni gjyqësor administrativ për rastet e ankimit ndaj vendimeve të KED-së, që ndalojnë kandidimin për vendet vakante për gjyqtarë në Gjykatën Kushtetuese është i kufizuar. Gjykata Administrative e Apelit vlerëson vetëm nëse gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të kandidaturave nga KED-ja janë kryer shkelje të rënda të procedurës, ndërsa përcaktimi i natyrës përfundimtare dhe i formës së prerë të këtij vendimi, e bën atë të paankimueshëm në një gjykatë më të lartë. Në këtë kuptim, vendimet e kësaj natyre janë përfundimtare dhe ndaj tyre nuk mund të ushtrohet rekurs nga palët.



19. Gjykata thekson se duke parashikuar vetëm një shkallë ankimi, ligjvënësi ka pasur në vëmendje prioritetin e plotësimit të vendeve vakante në Gjykatën Kushtetuese, në kuadrin e funksionimit të këtij institucioni kushtetues. Në këtë drejtim, duke pasur parasysh rolin dhe funksionin e saj si garante e Kushtetutës, Gjykata vlerëson se qëllimi i ligjvënësit në përcaktimin e vetëm një shkalle gjykimi ndaj vendimeve të KED-së, që vendosin ndalimin e kandidimit, i përgjigjet nevojës për të mos krijuar zvarritje/vonesa për plotësimin e vendeve vakante në një institucion të rëndësishëm kushtetues siç është Gjykata Kushtetuese.

20. Gjykata rithekson se ndalimi i paraqitjes së rekursit nuk cenon të drejtën për një proces të rregullt ligjor, pasi shteti nuk ka detyrim të parashikojë më shumë se një shkallë ankimi, për sa kohë që ka një ankim në një gjykatë të parashikuar me ligj, në kuptim të nenit 43 të Kushtetutës, si dhe nenit 13 të KEDNJ-së (*shih vendimin nr. 1, datë 16.1.2017, të Gjykatës Kushtetuese*). Ky qëndrim është në të njëjtën linjë edhe me Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), e cila ka theksuar rëndësinë e ushtrimit të kontrollit gjyqësor ndaj çdo vendimi të organeve që vlerësojnë kandidaturat, përzgjedhin dhe vendosin për karrierën e gjyqtarëve, ose të paktën të procedurës sipas së cilës merret një vendim i tillë. Megjithatë, e drejta e aksesit në gjykata nuk është absolute dhe ajo mund të jetë objekt i kufizimeve, me kusht që të mos cenohet thelbi i së drejtës. Një kufizim nuk do të jetë në përputhje me nenin 6 § 1 nëse nuk ndjek një qëllim legjitim dhe nëse nuk ka një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që kërkohet të arrihet (*shih vendimin e GJEDNJ-së në çështjen Gloveli kundër Gjeorgjisë, datë 7.4.2022, § 51 dhe 57*).

21. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se kërkuesi ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion për kundërshtimin e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit. Gjithashtu, ai legjitimohet *ratione temporis*, pasi vendimi i kundërshtuar i dhënë nga Gjykata Administrative e Apelit është i datës 9.12.2020, kurse kërkesa në Gjykatë është paraqitur në datën 9.4.2021, pra brenda afatit 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

22. Për legjitimitimin *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkuesi ka kërkuar shfuqizimin e vendimit të KED-së, si dhe të vendimit të Gjykatës

Administrative të Apelit duke pretenduar cenimin e parimit të mosdiskriminimit, barazisë para ligjit, së drejtës për jetë familjare dhe profesionale, së drejtës për t’u dëgjuar dhe parimit të kontradiktoritetit, si dhe të parimit të sigurisë juridike.

23. Në këndvështrim të legjitimitimit *ratione materiae*, Gjykata thekson se në nenin 71/a, pika 1, shkronja “ç”, të ligjit nr. 8577/2000 parashikohet si kriter tjetër edhe se shqyrtimi i çështjes nga Gjykata do të mund të rivendoste në vend të drejtën e pretenduar të shkelur të individit.

24. Për sa i përket vlerësimit të këtij kriteri në rastin e kërkuesit, në përfundim të diskutimeve, në zbatim të nenit 72, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, Gjykata nuk arriti numrin e kërkuar të votave për vendimmarrje, sipas parashikimeve të nenit 133, pika 2, të Kushtetutës, të detajuar edhe në nenin 72, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000.

25. Kështu, sipas njërës qëndrim, u vlerësua se kërkuesi legjitimohet *ratione materiae* në kërkesën drejtuar Gjykatës, pasi pretendimet e ngritura në ankimin kushtetues bëjnë pjesë në juridiksionin dhe kompetencën e Gjykatës, e cila, në rastin e ankimit kushtetues individual, shqyrtton pretendimet për gjykimet përfundimtare, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese. Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore përfundimtare, në rastet kur ankuesi është gjyqumbës, nuk përbën pamundësi për rivendosjen në vend të të drejtave kushtetuese të shkelura, për rrjedhojë nuk është shkak për mospranimin e ankimit kushtetues individual. Nën këtë analizë, plotësimi nga organet e emërtesës në dhjetor të vitit 2020 të vendeve vakante, për të cilat kërkuesi ka qenë në proces verifikimi në KED, si dhe fillimi i procedurës së radhës për të njëjtat pozicione, nuk përbëjnë “*pamundësi të rivendosjes në vend të të drejtave kushtetuese të kërkuesit nga shqyrtimi i çështjes kushtetuese nga Gjykata*”, në kuptim të juridiksionit dhe kompetencës lëndore të saj sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës dhe nenit 71/a, pika 1, shkronja “ç”, të ligjit nr. 8577/2000³.

26. Sipas qëndrimit tjetër u vlerësua se në zbatim të nenit 71/a, pika 1, shkronja “ç”, të ligjit nr. 8577/2000, shqyrtimi i çështjes nga Gjykata nuk do të rivendoste në vend të drejtat që kërkuesi

³ Votuan për legjitimitimin *ratione materiae* të kërkuesit gjyqtarët Marsida Xhaferllari, Sonila Bejtja dhe Ilir Toska.



pretendon se i janë shkelur. Vendet vakante për të cilat kërkuesi ka aplikuar janë plotësuar me dy gjyqtarë kushtetues, të emëruar përkatësisht nga Presidenti dhe Kuvendi, të cilët kanë filluar ushtrimin e detyrës në muajin dhjetor të vitit 2020. Për më tepër, Gjykata, bazuar në nenin 127, pikat 1, shkronja “b”, 2 dhe 3, të Kushtetutës, si dhe nenet 8, pika 3 dhe 9, pikat 1, shkronja “b” dhe 2, të ligjit nr. 8577/2000, me vendimet nr. 41, datë 22.12.2021 dhe nr. 42, datë 22.12.2021, ka deklaruar mbarimin e mandatit të këtyre gjyqtarëve, duke iniciuar kështu edhe procedurën e zëvendësimit të tyre nga organet e emërtesës. Një ndër mënyrat se si mund të rivendoset në vend e drejta e pretenduar e cenuar është nëpërmjet vendimmarrjes së Gjykatës për shfuqizimin e vendimeve objekt kundërshtimi, si të papajtueshme me Kushtetutën, dhe rikthimin e çështjes për rishqyrtim në gjykatën përkatëse ose konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese, duke i “detyruar” organet të veprojnë në mënyrën më efektive për të rivendosur në vend të drejtën. Në këtë këndvështrim, shqyrtimi i pretendimeve të paraqitura nga kërkuesi përmes ankimit kushtetues individual dhe shfuqizimi i vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit nuk do të sillnin rezultate konkrete në drejtim të rivendosjes në vend të së drejtës së pretenduar të cenuar⁴.

27. Për sa më lart, Gjykata vëren se në kushtet kur nuk u formua shumica prej 5 gjyqtarësh, në kuptim të nenit 73, pika 4, të ligjit nr. 8577/2000, kërkesa e kërkuesit konsiderohet e rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P”, 133, pika 2 dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71, 72, 73, pika 4, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

⁴ Votuan për moslegjitimimin *ratione materiae* të kërkuesit gjyqtarët Elsa Toska, Altin Binaj dhe Sandër Beci.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 27.10.2022.

Shpallur më 18.11.2022

Kryesuese: Marsida Xhaferllari

Anëtarë: Sonila Bejtja, Elsa Toska, Altin Binaj, Ilir Toska, Sandër Beci

NJOFTIM

Nr. 17391, datë 17.11.2022

MBI HYRJEN NË FUQI TË MARRËVESHJES NDËRKOMBËTARE

“Protokolli ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë për trajnimin dhe bashkëpunimin në fushën e shëndetësisë ushtarake, nënshkruar më 24.3.2021”, ka hyrë në fuqi më 4 nëntor 2022.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I
MINISTRISË PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME
Gazmend Turdiu

KËRKESË

Nr. 795/9, datë 17.11.2022

PËR SHPRONËSIM DHE/OSE PËR SHKËMBIMIN E PRONËS PËR INTERES PUBLIK

Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën për shpronësim dhe/ose shkëmbim, të pronës për interes publik në zonën e re për zhvillim në Njësinë Administrative nr. 11, “Universiteti Bujqësor i Tiranës”.

Njësia zbatuese për këtë projekt është Bashkia Tiranë.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim dhe/ose për shkëmbim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogarit, si:

1. Për pasuritë e llojit “truall” është bërë bazuar në vendimin nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të



Ministrave, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelat e publikuara dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare dhe në portalin unik qeveritar për rindërtimin, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentet përkatëse pranë Bashkisë Tiranë, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin, duke u shprehur nëse pranojnë kalimin vullnetar të pronësisë me kushtet e ofruara.

Kërkesa për shpronësim dhe/ose shkëmbim të pronës, për interes publik, në zonën e re për zhvillim në Njësinë Administrative nr. 11,

“Universiteti Bujqësor i Tiranës”, në funksion të procesit të rindërtimit, përmes kompensimit në vlerë, rezulton në shumën prej 133 968 072.50 (njëqind e tridhjetë e tre milionë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e shtatëdhjetë e dy pikë pesëdhjetë) lekësh, vlerën e ndryshuar, sipas rastit, pas veprimeve për lidhjen e marrëveshjeve/kontratave të shkëmbimit, mes pronarëve të shpronësuar dhe njësisë zbatuese.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM
TË SHPRONËSIMIT DHE/OSE
SHKËMBIMIT
Egra Ibrahim



LISTA EMËRORE PARAPRAKE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN, PËR INTERES PUBLIK, DHE/OSE SHKËMBEHEN PËR ZHVILLIMIN E DETYRUAR “ZONË E RE PËR ZHVILLIM”, NJËSIA ADMINISTRATIVE 11, UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS, BASHKIA TIRANË

Nr.	PRONARI			TË DHENAT (mbi pasurinë sipas ASHK-së)				VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM DHE/OSE KOMPENSIM SIPAS LLOJIT TË PASURISË										VLERA TOTALE (lek) Kompensim në vlerë	KONFRIMUAR/SHËNIME				
	Emri	Atësia	Mbiemri	ZK	Nr. i pas.	Lloji i pas.	Sip. truall/arë totale m²	Shpronësim tokë "truall"			Sip. ndërtese totale (m²)	Ndërtëse banimi (shënp)			Vlera (lek)	Sip. e prekur (m²)	Çmimi sipas sh/blejeve sipas ASHK-së (l/m²) për banesë		Vlera (lek)	Sip. e prekur (m²)	Çmimi sipas kostos së ndërtimit nga EKB (l/m²) për jo banesë	Vlera (lek)	
								Sip e prekur (m2)	Çmimi (lek/m²)	Vlera (lek)		Sip. e prekur (m²)	Çmimi mesatar sh/blejeve sipas ASHK-së (l/m²) për banesë	Vlera (lek)									
PRONE PRIVATE																							
1	Nyret Sat	Haki	Hachja Fani	8320	1/136	Truall	2,336.0	2,336.0	22,985.0	53,692,960.00									53,692,960.00				
2	Sat	Haki	Fani	8320	1/162	Truall	1,712.0	1,712.0	22,985.0	39,350,320.00									39,350,320.00				
4	Diana Robert Gene Julana	Aleksander Aleksander	Hosha Dako Ruli Mosi	8320	1/610	Truall	1,392.0	1,392.0	22,985.0	31,995,120.00									31,995,120.00		Nr. 00003519, 18.04.2019, emërtimi: INSK-2245, data 27.12.2007		
5	Jani	Sveta	Gjokopulli	8320	1/134	Truall	1,100.0	184.00	22,985.0	4,229,240.00									4,229,240.00				
6	Sofo	Mamo	Limaj	8320	1/637	Truall	300.0	49.5	22,985.0	1,137,757.50	70.0	0.0	0.0						1,137,757.50		Bllokohet në favor të NBKG sh.a.		
7	Sofo	Mamo	Limaj	8320	1/638	Truall	1,522.0	155.00	22,985.0	3,562,675.00	416.0	0.0	0.0						3,562,675.00		Pasuria bllokohet në favor të Intesa San Paolo Bank Albania sh.a. për shumën 125,000 euro		
Kompensimi në sipërfaqe (m²)							8,362.0	5,828.5			486.00	0.0	0.0		0.0	0.0		133,968,072.50					
REPUBLIKA E SHQIPËRISË																							
57	Republika e Shqipërisë			8320	1/567	Truall	9,888.0	668.9			1,975.5								0.0		Në përgjegjësi administrimi Universiteti Bujqësor i Tiranës		
18	Republika e Shqipërisë			8320	1/378	Truall	1,950.0	140.9											0.0		Në përgjegjësi administrimi Universiteti i Tiranës		
Kompensimi në sipërfaqe (m²)							9,888.0	809.8			1,975.50	0.0	0.0		0.0	0.0		0.00					
SHËTJET																							
1	Shëtit			8320	1/136	Truall	398.0	37.2											0.0				
2	Shëtit			8320	1/340	Truall	473.0	11.0											0.0				
3	Shëtit			8320	1/335	Truall	645.0	2.2											0.0				
4	Shëtit			8320	1/338	Truall	1,999.0	9.0											0.0				
5	Shëtit			8320	1/341	Truall	41.0	91.6											0.0				
6	Shëtit			8320	1/342	Truall	182.0	41.0											0.0				
7	Shëtit			8320	1/343	Truall	158.0	88.0											0.0				
8	Shëtit			8320	1/379	Rruge	504.0	2.7											0.0				
9	Shëtit			8320	1/410	Truall	878.0	43.5											0.0		Kjo pasuri është e okupuar nga një ndërtim pa leje		
10	Shëtit			8320	1/411	Truall	605.0	72.5											0.0				
11	Shëtit			8320	1/412	Rruge	235.0	258.8											0.0				
12	Shëtit			8320	1/362	Rruge	112.0	97.9											0.0				
13	Shëtit			8320	1/364	Truall	1,069.0	266.0											0.0				
14	Shëtit			8320	1/365	Trotuaire	41.0	398.5											0.0				
15	Shëtit			8320	1/367	Trotuaire	63.0	27.6											0.0				
16	Shëtit			8320	1/368	Truall	57.0	89.1											0.0				
17	Shëtit			8320	1/377	Truall	401.0	95.0											0.0				
19	Shëtit			8320	1/337	Truall	654.0	482.4											0.0				
20	Shëtit			8320	1/361	Truall	945.0	945.0											0.0		Kjo pasuri është e okupuar nga një ndërtim pa leje		
21	Shëtit			8320	1/438	Trotuaire	209.0	184.4											0.0				
22	Shëtit			8320	1/354	Truall	1,357.0	1,757.0											0.0		Shesh pallati		
23	Shëtit			8320	1/369	Truall	592.0	113.1											0.0		Shesh pallati		
24	Shëtit			8320	1/366	Rruge	683.0	150.8											0.0				
25	Shëtit			8320	1/431	Truall	198.0	198.0											0.0				
26	Shëtit			8320	1/430	Truall	132.0	70.4											0.0				
27	Shëtit			8320	1/376	Truall	603.0	72.6											0.0				
28	Shëtit			8320	1/254	Rruge	222.0	57.8											0.0				
30	Shëtit			8320	1/521	Truall	1,599.0	215.1											0.0				
31	Shëtit			8320	1/482	Truall	1,195.0	59.9											0.0				
32	Shëtit			8320	1/479	Truall	1,940.0	79.3			1,292.0								0.0		Fakulteti i Inzhinierisë		
33	Shëtit			8320	1/346	Truall	3,498.0	3,498.0											0.0				
34	Shëtit			8320	1/347	Trotuar	285.0	285.6											0.0				
35	Shëtit			8320	1/344	Truall	57.0	57.0											0.0				
36	Shëtit			8320	1/611	Truall	608.0	608.0											0.0				
38	Shëtit			8320	1/503	Trotuar	546.0	12.5											0.0				
39	Shëtit			8320	1/492	Rruge	1,741.0	132.0											0.0				
41	Shëtit			8320	1/471	Rruge	452.0	442.5											0.0				



42	Shtet	8320	1/359	Trotuar	50.0	50.0											0.0		
43	Shtet	8320	1/358	Trotuar	63.0	63.0											0.0		
44	Shtet	8320	1/357	Trotuar	292.0	292.0											0.0		
45	Shtet	8320	1/356	Rruge	1,051.0	1,051.0											0.0		
46	Shtet	8320	1/353	Trotuar	34.0	34.0											0.0		
47	Shtet	8320	1/352	Truall	58.0	58.0											0.0		
48	Shtet	8320	1/350	Rruge	985.0	985.0											0.0		
49	Shtet	8320	1/349	Truall	891.0	891.0											0.0		
50	Shtet	8320	1/348	Truall	415.0	415.0											0.0	Kjo pasuri është e okupuar nga një ndërtim pa leje	
51	Shtet	8320	1/351	Trotuar	264.0	264.0											0.0		
52	Shtet	8320	1/346	Truall	3,498.0	3,498.0											0.0	Kjo pasuri është e okupuar nga një ndërtim pa leje	
53	Shtet	8320	1/339	Rruge	272.0	272.0											0.0		
54	Shtet	8320	1/355	Truall	927.0	927.0											0.0	Kjo pasuri është e okupuar nga një ndërtim pa leje. Kjo pasuri ka qenë e Ndërmarrjes Tregtare të trajtimit të studentëve	
55	Shtet	8320	1/360	Truall	1,639.0	1,639.0											0.0		
58	Shtet	8320	1/418	Rruge	743.0	75.8											0.0		
59	Shtet	8320	1/415	Rruge	853.0	611.6											0.0		
60	Shtet	8320	1/414	Truall	877.0	877.0											0.0	Kjo pasuri është e okupuar nga një ndërtim pa leje	
61	Shtet	8320	1/416	Truall	191.0	191.0											0.0		
62	Shtet	8320	1/417	Truall	896.0	651.4											0.0	Kjo pasuri është e okupuar nga një ndërtim pa leje	
63	Shtet	8320	1/413	Rruge	1,001.0	852.0											0.0		
64	Shtet	8320	1/419	Truall	131.0	115.2											0.0		
65	Shtet	8320	1/421	Truall	537.0	325.0											0.0		
66	Shtet	8320	1/422	Truall	511.0	256.6											0.0	Kjo pasuri është e okupuar nga një ndërtim pa leje	
67	Shtet	8320	1/425	Truall	42.0	42.0											0.0		
68	Shtet	8320	1/426	Truall	169.0	132.0											0.0		
69	Shtet	8320	1/427	Truall	645.0	645.0											0.0	Kjo pasuri është e okupuar nga një ndërtim pa leje	
70	Shtet	8320	1/428	Trotuar	137.0	105.4											0.0		
71	Shtet	8320	1/429	Truall	165.0	165.0											0.0		
72	Shtet	8320	1/594	Truall	5,866.0	3,094.2											0.0		
Kompensimi në sipërfaqe (m²)					48,920.0	29,631.2				1,292.00							0.0		
Totali paraprak						36,269.50				1,778.00	0.00	0.00					0.00	0.00	133,968,072.50

Shënime:

- Llogaritjet paraprake të pasurive të kësaj liste janë bazuar në materialin e dërguar të ASHK-së Tirana Veri, në përgjigje të aplikimeve me nr. 25445, 25511, 25421, 25403, datë 11.3.2022, si dhe të aplikimeve AV, me nr. 49231, 49228, 49227, 49224, datë 3.6.2022.
- Për vlerësimin e pasurive të llojit truall i jemi referuar VKM-së nr. 89, datë 3.2.2016.



AKT MARRËVESHJE
Nr. 25076, datë 11.11.2022

LIDHUR NDËRMJET PALËVE
GRUPEVE TË INTERESIT PËRFAQËSUES TË AUTOSHKOLLAVE, SHOQATA “KOMBËTARE E AUTOSHKOLLAVE”, me numër identifikimi (NIPT) L71715471D, e regjistruar me vendimin nr. 1094, datë 16.7.2004, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me seli në adresën: rruga “Hasan Sufa”, p. 2, sh. 4, Tiranë, me anëtarësi 258 autoshkolla (sipas listës së anëtarësisë bashkëlidhur pjesë e pandarë e marrëveshjes), përfaqësuar nga kryetari i shoqatës **z. Agron Beja dhe SHOQATA E AUTOSHKOLLAVE “SIGURIA NË RRUGË”,** me numër identifikimi (NIPT) L81527454T, e regjistruar me vendimin nr. 5811, datë 9.3.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me seli në adresën: rruga “Muhamet Gjollësja”, pallatet “Toena”, kati 3, me 9 anëtarë themelues (sipas aktit të themelimit bashkëlidhur pjesë e pandarë e marrëveshjes), përfaqësuar nga kryetari i shoqatës **z. Behar Laze,** të cilat kanë si mision të përbashkët të mbrojnë interesat e të gjithë anëtarëve që marrin pjesë në veprimtarinë e autoshkollave, si dhe të marrin pjesë në diskutimin e akteve ligjore për autoshkollat dhe sigurinë në rrugë.

dhe

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT RRU-GOR (referuar si DPSHTRR), me seli në adresën: rruga “Muhedin Llagani”, nr. 10, Tiranë, është institucion shtetëror, me statusin e personit juridik publik, me vetëfinancim, në varësi të ministrit përgjegjës për punët publike dhe transportet, i krijuar sipas vendimit nr. 343, datë 21.7.1999, “Për krijimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor”, të Këshillit të Ministrave, përfaqësuar nga drejtori i përgjithshëm, **z. Blendi GONXHJA,**

në vijim të quajtura “palët”,

Të vetëdijshëm për rëndësinë e bashkëpunimit për forcimin e shtetit ligjor, për rregullimin e aktivitetit të autoshkollave;

Me dëshirën e mirë për të kombinuar në bashkëpunim nëpërmjet zhvillimit të marrëdhënieve ndërmjet dy palëve,

Me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë deklarojnë se bien dakord, për sa më poshtë:

Baza ligjore

1.1 Ligji nr. 8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

1.2 Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 153, datë 7.4.2000, “Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

1.3 Udhëzimi i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) nr. 9, datë 14.4.2022, “Për aktivitetin e autoshkollave”, në zbatim të nenit 3 dhe nenit 8.

Neni 1

Objekti

1.1 Objekti i kësaj Marrëveshjeje është dakordësimi, organizimi i burimeve teknike të autoshkollës dhe përcaktimi i kriterëve për hapjen e autoshkollave të reja, sipas numrit të popullsisë, brenda një territori të caktuar, në rang bashkie apo qarku; përcaktimi i moshës së mjeteve të autoshkollave që licencohen pas hyrjes në fuqi të udhëzimit të MIE-s nr. 9, datë 14.4.2022, “Për aktivitetin e autoshkollave”.

1.2 Bashkëpunimi midis palëve është i domosdoshëm dhe i rëndësishëm pasi ndihmon në luftën ndaj konkurrencës së pandershme, rregullimin e tregut të autoshkollave, kontributit në kuadër të çështjes me rëndësi të madhe publike mbi sigurinë rrugore, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit publik dhe përmirësimit të sigurisë në rrugë, të cilat luajnë një rol të rëndësishëm në një proces zinxhir, duke filluar nga përdoruesit e rrugës dhe homogeniteti i masave në këtë drejtim.

Neni 2

Hapja e autoshkollave të reja në rang qarku sipas numrit të popullsisë

2.1 Vendimet miratuese për ushtrimin e veprimtarisë së autoshkollave mund të lëshohen me kusht që të respektohet raporti i numrit të popullsisë **për nivel qarku si më poshtë:**

a) për qarqet që kanë të paktën **500.000 banorë** të respektohet raporti një autoshkolle për çdo **15.000 banorë;**

b) për qarqet **nga 200.000 deri në 500.000 banorë** të respektohet raporti një autoshkolle për çdo **12.000 banorë;**



c) për qarqet nga 100.000 deri në 200.000 banorë të respektohet raporti një autoshkolle për çdo 10.000 banorë;

d) për qarqet me më pak se 100.000 banorë të respektohet raporti një autoshkolle për çdo 8.000 banorë.

2.2 Numri i popullsisë sipas qarqeve do të merret nga të dhënat e publikuara në faqen zyrtare të INSTAT-it.

Neni 3

Mosha e mjeteve të autoshkollave

3.1 Mosha e mjeteve të autoshkollave, që licencohen pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje do të jetë:

- 10 vjet për mjetet e kategorive: AM, A1, A2, A, B1, B, BE;

- 15 vjet për mjetet e kategorive: C1, C, C1E, CE, D1, D, D1E, DE.

3.2 Kriteri i përmendur në pikën 3.1 do të zbatohet dhe për të gjitha autoshkollat që do të shtojnë mjete të reja në veprimtarinë e tyre.

Neni 4

Përfaqësimet dhe garancitë e Palëve

4.1 Secila palë, në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje siguron palën tjetër, që:

a) është e autorizuar të përmbushë të gjitha detyrimet e parashikuara nga kjo Marrëveshje;

b) përmbushja e detyrimeve të kësaj Marrëveshjeje, si dhe e të gjithë Marrëveshjes në tërësi nuk bie në kundërshtim me legjislacionin shqiptar në fuqi;

c) detyrimet e kësaj Marrëveshjeje janë të ligjshme, të vlefshme dhe të detyrueshme për t'u zbatuar.

4.2 DPSHTRR-ja garanton se do të njohë me këtë marrëveshje MIE-në dhe QKB- në.

4.3 Grupet e interesit garantojnë se do të njohin me këtë marrëveshje dhe detyrimet që rrjedhin prej saj, të gjithë anëtarët e shoqatës që përfaqësojnë.

Neni 5

Cenimi i ndonjë dispozite të Marrëveshjes

5.1 Në rast se ndonjë prej dispozitave të kësaj Marrëveshjeje bëhet e pavlefshme, e paligjshme ose e pamundur për t'u zbatuar sipas legjislacionit në

fuqi, vlefshmëria, ligjshmëria dhe zbatimi i dispozitave të tjera të Marrëveshjes nuk cenohen.

5.2 Palët, në mirëbesim, mund të negociojnë për të zëvendësuar dispozitën e mësipërme me një dispozitë tjetër.

Neni 6

Amendimet

6.1 Palët do të bëjnë amendime në këtë marrëveshje bazuar në ndryshimet e legjislacionit në fuqi edhe pëlqimin e ndërsjellë të paraqitur me shkrim.

Neni 7

Koordinimi ndërmjet palëve

7.1 Secila palë do të caktojë një person kontakti, që do të jetë përgjegjës për zbatimin konkret të Marrëveshjes së Bashkëpunimit.

7.2 Komunikimi ndërmjet palëve do të jetë në formë shkresore ose elektronike në adresat zyrtare të palëve si më poshtë:

DPSHTRR: dpshttr@dpshttr.gov.al

Shoqata “Siguria në Rugë”:

“Shoqata Kombëtare e autoshkollave”:
sh.kombetare@gmail.com

Neni 8

Zbatimi i marrëveshjes

8.1 Palët marrin përsipër zbatimin e kësaj Marrëveshjeje nga data e hyrjes së saj në fuqi dhe do të përpiqen t'i zgjidhin me mirëkuptim të gjitha mosmarrëveshjet që mund të rrjedhin gjatë zbatimit.

8.2 Çdo ndryshim i bërë, për aq sa ato lidhen me aktmarrëveshje, do të reflektohen zyrtarisht edhe në ndryshimin e saj.

Neni 9

Hyrja në fuqi

9.1 Kjo Marrëveshje hyn në fuqi dhe bëhet e detyrueshme për t'u zbatuar 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas nënshkrimit të saj.

9.2 Marrëveshja është e vlefshme për një afat të pacaktuar.



9.3 Kjo Marrëveshje mund të përfundojë në çdo kohë duke njoftuar paraprakisht me shkrim palën tjetër të paktën 1 (një) muaj më parë.

9.4 Kjo Marrëveshje hartohet në 3 (tri) kopje origjinale, nga të cilat 1 (një) për Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor dhe 2 (dy) për grupet e interesit.

Nënshkruar në Tiranë, sot, më datë 11. 11.2022.

PËR GRUPET E INTERESIT
PËRFAQËSUES TË
AUTOSHKOLLAVE

SHOQATA KOMBËTARE E
AUTOSHKOLLAVE
KRYETAR
Agron Beja

SHOQATA E
AUTOSHKOLLËS
“SIGURIA NË RRUGË”
KRYETAR
Behar Laze

PËR DREJTORINË E
PËRGJITHSHME
TË SHËRBIMEVE TË
TRANSPORTIT RRUGOR

DREJTOR I
PËRGJITHSHËM
Blendi Gonxhja

KORRIGJIM GABIMI MATERIAL

Në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 284, datë 7.11.2022, “Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 150, datë 10.6.2022, ‘Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë ‘Danske Commodities Albania’ sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike’”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 152 , datë 15 nëntor 2022, bëhet korrigjimi i datës së vendimit si më poshtë:

Ishte:
VENDIM
Nr. 284, datë 7.10.2022

Bëhet:
VENDIM
Nr. 284, datë 7.11.2022

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2022

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 112 lekë